

VENDIM
Nr. 170, datë 26.3.2014

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT,
DATË 15.1.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 13620/10, “TUSHAJ KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për çështjen nr. 13620/10, “Tushaj kundër Shqipërisë”, në shumën 1 300 (një mijë e treqind) euro, plus edhe çdo taksë që mund të jetë e tatueshme në lidhje me dëmin moral, shumën prej 500 (pesëqind) eurosh, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për kostot dhe shpenzimet. Vlera në total e detyrimit është 1 800 (një mijë e tetëqind) euro.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Lekë Tushaj, në vlerën që shteti shqiptar i detyrohet atij, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për ankimin nr. 13620/10, “Tushaj kundër Shqipërisë”.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z. Lekë Tushaj, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit. Afati i zbatimit të këtij vendimi është pagesa në transhin e parë të pagesës së detyrimeve të prapambetura, mbështetur në strategjinë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i shtetit, zëri “Detyrimet e prapambetura”.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama